

Gjergj Elez Alia

-Pyetje me shtjellim-

PJESA E PARË

-shënime-

1.

Kënga e Gjergj Elez Alisë nuk ka të përbashkët as bëmat dhe as heronitë me Ciklin e njohur të Mujit e Halilit. Megjithatë, shumë studiues e kanë kuadruar atë në këtë cikël. Si mund ta argumentojmë këtë?

**Gjeni ngjashmëri duke analizuar në të dyja rastet bazën historike të krijimit të këngëve, problematikën, cilësitë e heronjve dhe formën artistike.*

2. (Pyetje shtesë)

Jepni disa shpjegime për prejardhjen dhe kuptimin e fjalës kreshnik.

3.

*Trim mbi trima ai Gjergj Elez Alia,
qe nandë vjet nandë varra n'shtat m'i ka.*

Përveç deklarimit "trim mbi trima", cili është detaji tjetër që të bind për trimërinë e Gjergj Elez Alisë, që e përforcon dhe e plotëson atë?

4.

Dashuria e motrës për Gjergj Elez Alinë është kthyer në simbol të dashurisë mes motrës dhe vëllait. Në ç'forma del kjo dashuri në vargjet e mëposhtme?

*Trim mbi trima ai Gjergj Elez Alia,
qe nandë vjet nandë varra n'shtat m'i ka.
Veç një motër natë e ditë te kryet
ia lanë varrat me ujt e gurrs' nandë vjeçe,
ia lanë varrat me ata lott' e syve,
ia ter gjakun me ata flokt' e ballit;*

**Vini re vargjet që tregojnë se çfarë bën motra për të vëllain.*

-shënime-

5. (Pyetje shitesë)

Ilustroni dashurinë mes motrës dhe vëllait duke analizuar këto vargje:

*

*ia lanë varrat me ata lott' e syve,
ia ter gjakun me ata flokt' e ballit;*

*

*Sa herë trupin motra p'e tërnueke
dhimbn' e varrëve vllau krejt e harrueke
dhimba e motrës dekun n'tok e lëshueke.*

*

*Amanet, mori motër, pse po kan?
Zemrën dyshë, mori motër, pse ma dan?*

*

*Të dy zemrat përiherë po janë ndalur!
Kurkujt shpirti ma mirë s'i ka dalun!*

6.

Kënga e Gjergj Elez Alisë hyn në fondin e këngëve legjendare, tipar i të cilave është pjesëmarrja në këngë e elementeve mitike e të mbinatyrshme. Ilustroni këtë mendim në vargjet e mëposhtme (gjeni një element të tillë të mbinatyrshëm):

*Trim mbi trima ai Gjergj Elez Alia,
qe nandë vjet nandë varra n'shtat m'i ka.
Veç një motër natë e ditë te kryet
ia lanë varrat me ujt e gurr's nandë vjeçe.*

7.

Gjeni ndryshimin midis këtyre dy vargjeve:

*shtatin vllaun ia shtërngon n'ruba t'nanës;
n'petka t'babës trupin ia hijeshon;*

8.

Gjergji ka nëntë vjet që nuk është ngritur nga shtrati, ka nëntë vjet që nuk i ka përdorur armët. Pse e motra këmbëngul që "armt' e brezit t'ja rendojë mbi krye"?

-shënime-

9.

Në vargjet: [balozi] *trim* i prapt' e belagji që ish kanë / n'fushë t'mejdanit *trimat* konkan dalë

rapsodi popullor këmbëngul ta quajë balozin trim, ashtu siç quan dhe heroin, Gjergj Elez Alinë. Ndërkohë, balozi simbolizon të keqen, dhunën etj., pra s'mund të barazohet në epitete me heroin. Si mund ta shpjegojmë këtë këmbëngulje të rapsodit?

10.

Gjergj Elez Alia dhe Balozi janë të dy trima. Gjeneri nga një varg për të ilustruar llojin e trimërisë të secilit.

11. (Pyetje shtesë)

Jepni kuptimin historik të fjalës baloz dhe kuptimin që ka në këngë.

12.

Komentoni kuptimin e taksës së rëndë që balozi i ka vënë vendit.

*Ja ki' qitun dheut një rreng të randë:
"Tim për tim kah një dash të pjekun,
tim për tim kah një vashë me ja djergun,
ditë me ditë kah një kreshnik me premun,
javë për javë kah një krahinë me djegun!"*

13. (Pyetje shtesë)

A janë të "logjikshme" ose "të arsyeshme" të gjitha kërkesat e balozit, brenda "logjikës së pushtuesit"?

*Tim për tim-o ka një dash të pjekun
tim për tim-o ka një vashë m'ja djergun,
ditë për ditë ka një kreshnik me premun,
javë për javë ka një krahinë me djegun.*